Nr: 10-133

Shkup:

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar lidhur me Njoftimin për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimin për informacione shtesë për formën e njoftimit për ndihmë rajonale nr. 10-133, të datës 10.09.2026, të parashtruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, për dhënien e ndihmës rajonale të planifikuar Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, në seancën e mbajtur më 29.09.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimit për informacione shtesë për formën e njoftimit për ndihmë rajonale nr. 10-133, të datës 10.09.2026, të paraqitura nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, për dhënien e ndihmës rajonale të planifikuar Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, si përfituese e ndihmës shtetërore, konstatoi se:

Masa

- **Pagesa e grantit në para në lartësi prej 13% të shumës së shpenzimeve të arsyeshme të investimit të realizuara nga përfituesi i ndihmës shtetërore, por jo më shumë se 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë në denarë, në nivel vjetor, në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e vonshme se 31.12.2029)**

paraqet ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore dhe paraqet **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale si ndihmë individuale, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, me ç’rast dhënia e saj lejohet.**

Kjo ndihmë shtetërore e planifikuar do të llogaritet në baza vjetore për vitin paraprak.

Masa

- **Pagesa shtesë e grantit në para në lartësi prej 13% të shumës së shpenzimeve të arsyeshme të investimit të realizuara nga përfituesi i ndihmës shtetërore, por jo më shumë se 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë në denarë, në nivel vjetor, në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e**

vonshme se 31.12.2029), nëse përfituesi i ndihmës shtetërore e ruan ose e zvogëlon numrin mesatar të të punësuarve për më pak se 5% në vitin e fundit, në krahasim me numrin mesatar të të punësuarve në tre vitet paraprake, dhe i rrit të ardhurat e përgjithshme për më shumë se 5% në vitin e fundit, në krahasim me të ardhurat mesatare të përgjithshme në tre vitet paraprake.

paraqet ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore dhe paraqet **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale si ndihmë individuale, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, me ç'rast dhënia e saj lejohet.**

Kjo ndihmë shtetërore e planifikuar do të llogaritet në baza vjetore për vitin paraprak.

Masa

- **Pagesa e 50% të tatimit të paguar mbi të ardhurat personale në bazë të pagës për të punësuarit e angazhuar për herë të parë nga përfituesi i ndihmës shtetërore në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e vonshme se 31.12.2029), të angazhuar ekskluzivisht për nevojat e Projektit Investues të përshkruar në Planin e Biznesit, për të cilët paguhet pagë mesatare mujore neto më e lartë për së paku 50% nga lartësia e pagës minimale neto të përcaktuar me Ligjin për Pagën Minimale, e cila ka qenë në fuqi gjatë asaj periudhe, për më së shumti 2000 (dy mijë) të punësuar, e llogaritur dhe e paguar nga përfituesi i ndihmës shtetërore në përputhje me Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, ndërmjet Datës së Fillimit dhe Datës së Përfundimit.**

paraqet ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore dhe paraqet **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale si ndihmë individuale, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, me ç'rast dhënia e saj lejohet.**

Kjo ndihmë shtetërore e planifikuar do të llogaritet në baza vjetore për vitin paraprak.

Përfituesi i ndihmës shtetërore duhet të investojë shpenzime të arsyeshme investuese në shumën prej së paku 6.000.000 (gjashtë milionë) euro në kundërvlerë në denarë për projektin investues deri në datën e përfundimit.

Në përputhje me Planin e Biznesit, Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir planifikon të realizojë aktivitete investuese të cilat do të përfshijnë blerjen e makinerive, pajisjeve dhe programeve kompjuterike të reja, si dhe rritje të konsiderueshme të numrit të të punësuarve, me planifikim për 2000 (dy mijë) punësime.

Përfituesi i ndihmës obligohet ta mirëmbajë investimin, përkatësisht asetet (objektet, makineritë, pajisjet), në gjendje prodhuese, operative dhe të përdorshme (domethënë, nuk do ta zvogëlojë vlerën e aseteve), për një periudhë prej së paku 5 vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e mirëmban investimin, duhet ta kthejë të gjithë shumën e ndihmës shtetërore të përfituar në përputhje me Marrëveshjen për Ndihmë Shtetërore, së bashku me normën e interesit ndëshkues, të llogaritur në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën duke filluar nga pagesa e parë e kryer nga dhënësi i ndihmës shtetërore te përfituesi i ndihmës shtetërore, deri në momentin kur përfituesi i ndihmës shtetërore do ta kthejë shumën e përgjithshme të përfituar në llogarinë e dhënësit të ndihmës shtetërore.

Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e përmbush kushtin për të investuar shpenzime të arsyeshme investuese në shumën prej së paku 6.000.000 euro në kundërvlerë në denarë për projektin investues deri në datën e përfundimit, ai nuk do të ketë të drejtë në ndihmë shtetërore në përputhje me Marrëveshjen për Ndihmë Shtetërore, përkatësisht përfituesi do ta kthejë të gjithë shumën e ndihmës shtetërore të përfituar në përputhje me Marrëveshjen për Ndihmë Shtetërore, së bashku me normën e interesit ndëshkues, të llogaritur në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën duke filluar nga pagesa e parë e kryer nga dhënësi i ndihmës shtetërore te përfituesi i ndihmës shtetërore, deri në momentin kur përfituesi i ndihmës shtetërore do ta kthejë shumën e përgjithshme të përfituar në llogarinë e dhënësit të ndihmës shtetërore.

Përfituesi i ndihmës do të financojë së paku 25% të shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues nga burimet e veta ose me financim nga një palë e tretë, në formë e cila nuk paraqet ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Ndihma shtetërore rajonale kumulative për projektin investues nuk mund të jetë më e madhe se 50% e shumës së konfirmuar të të gjitha shpenzimeve të arsyeshme investuese të realizuara deri në datën e përfundimit, duke përfshirë edhe shpenzimet e arsyeshme investuese të realizuara deri në datën e përfundimit, të cilat tejkalojnë shumën minimale të kontraktuar të investimit prej 6.000.000 milionë eurosh si shpenzime të arsyeshme investuese.

2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sekretariati i Përgjithshëm, që Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës t'i dorëzojë një kopje të Marrëveshjes së lidhur (të nënshkruar) për dhënien e ndihmës shtetërore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, dhe KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, si përfituese e ndihmës shtetërore.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: KMK) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të mbështetjes, përkatësisht për të përcaktuar nëse ajo paraqet apo nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore, i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, që KMK-së t'i paraqesë njoftim për çdo plan për dhënien e ndihmës së re ose për ndryshimin e ndihmës ekzistuese shtetërore, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

Duke vepruar në përputhje me detyrimin për njoftim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, dorëzoi Njoftimin për dhënien e planifikuar të ndihmës dhe Njoftimin për informacione shtesë për formën e njoftimit për ndihmë rajonale për Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, me adresë: Rr. A nr., Zona Industriale – Zhabel, ZHABEL, MANASTIR, Republika e Maqedonisë së Veriut, nr. 10-133, të datës 10.09.2026 (në tekstin e mëtejmë: njoftimet), Propozim-marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir (të panënshkruar) (në tekstin e mëtejmë: Propozim-marrëveshja), Letër për qëllimin e investimit me Plan Biznesi për projektin investues dhe të dhëna për subjektin afarist nr. 15-41/1, të datës 08.04.2026, Plotësim dhe specifikim i letrës së qëllimit me Planin e azhurnuar të Biznesit për projektin investues dhe të dhëna për subjektin afarist, nr. ark. 15-4665/1, të datës 20.05.2026.

Duke pasur parasysh faktin se njoftimet e paraqitura përmbajnë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës në përputhje me nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, si ditë e pranimit të njoftimit të rregullt konsiderohet 10.09.2026.

KMK-ja, brenda afatit të paraparë ligjor, i shqyrtoi njoftimet e dorëzuara dhe Propozim-marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir (të panënshkruar nga palët kontraktuese) dhe konstatoi gjendjen faktike si vijon:

- **Dhënëse e ndihmës shtetërore është:** Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Përfituese e ndihmës shtetërore është:** Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, me seli në adresën: Rr. A nr., Zona Industriale – Zhabel, ZHABEL, MANASTIR, Republika e Maqedonisë së Veriut.
- **Baza juridike për dhënien e ndihmës shtetërore** paraqet aktin juridik në bazë të të cilit jepet ndihma – Propozim-marrëveshja për dhënien e ndihmës shtetërore Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësi i ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative katër kriteret e mëposhtme:

- Një masë e tillë të përfshijë transferimin e mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të paraqesë përparësi ekonomike për përfituesin; dhe
- Të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë.

Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të masave të përfshira në njoftimet e dorëzuara, KMK-ja i analizoi ato nga aspekti nëse i plotësojnë katër kriteret e lartpërmendura kumulative. Gjatë kësaj analize, KMK-ja konstatoi se:

- Masa**: Pagesa e grantit në para në lartësi prej 13% të shumës së shpenzimeve të arsyeshme të investimit të realizuara nga përfituesi i ndihmës shtetërore, por jo më shumë se 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë në denarë, në nivel vjetor, në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e vonshme se 31.12.2029),**

e paraparë në nenin 4 të Propozim-marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, **paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, për shkak se i plotëson kushtet e mëposhtme kumulative:

- Një masë e tillë përfshin transferimin e mjeteve shtetërore, për shkak se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje konkrete – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, për shkak të së cilës vjen deri te prishja e ekuilibrit ndërmjet ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Konkretisht, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se, me dhënien e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike vendosen në pozitë të pafavorshme. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir gjendet në pozitë selektive, duke pasur parasysh faktin se këto mjete mund t'i shfrytëzojë në mënyrën më fitimprurëse për të, me qëllim të arritjes së fitimit më të madh;
- Përparësia ekonomike për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje konkrete – Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir dhe prodhimit të saj të pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, përparësi të cilën kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe të biznesit;
- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë. Konkretisht, nga dhënia e kësaj mase shihet qartë se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me ç'rast konkurrenca dëmtohet ose mund të dëmtohet përmes mundësimit të një përparësie ekonomike për ndërmarrjen konkrete, Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.

Përveç konstatimit se masa e lartpërmendur paraqet ndihmë shtetërore, KMK-ja konstatoi gjithashtu se kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale**, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të ndërlidhura me investimet**.

KMK-ja gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur **paraqet ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që nuk është ndihmë shtetërore që jepet në bazë të një skeme ndihme, por jepet me detyrimin për miratim plotësues nga ana e KMK-së.

Gjatë vlerësimit të lejueshmërisë së dhënies së ndihmës, KMK-ja përcakton nëse dhënia e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës rajonale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 109/13).

Dhënësi i ndihmës shtetërore do t'ia paguajë këtë ndihmë shtetërore përfituesit të ndihmës shtetërore brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për pagesë nga dhënësi i ndihmës shtetërore, vetëm me kusht që përfituesi i ndihmës shtetërore t'i ketë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të përcaktuara në Propozim-marrëveshje.

- **Masa: Pagesa shtesë e grantit në para në lartësi prej 13% të shumës së shpenzimeve të arsyeshme të investimit të realizuara nga përfituesi i ndihmës shtetërore, por jo më shumë se 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë në denarë, në nivel vjetor, në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e vonshme se 31.12.2029), nëse përfituesi i ndihmës shtetërore e ruan ose e zvogëlon numrin mesatar të të punësuarve për më pak se 5% në vitin e fundit, në krahasim me numrin mesatar të të punësuarve në tre vitet paraprake, dhe i rrit të ardhurat e përgjithshme për më shumë se 5% në vitin e fundit, në krahasim me të ardhurat mesatare të përgjithshme në tre vitet paraprake,**

e paraparë në nenin 4 të Propozim-marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, **paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, për shkak se i plotëson kushtet e mëposhtme kumulative:

- Një masë e tillë përfshin transferimin e mjeteve shtetërore, për shkak se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje konkrete – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, për shkak të së cilës vjen deri te prishja e ekuilibrit ndërmjet ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Konkretisht, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se, me dhënien e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike vendosen në pozitë të pafavorshme. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir gjendet në pozitë selektive, duke pasur parasysh faktin se këto mjete mund t'i shfrytëzojë në mënyrën më fitimprurëse për të, me qëllim të arritjes së fitimit më të madh;
- Përparësia ekonomike për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje konkrete – Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT

MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir dhe prodhimit të saj të pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, përparësi të cilën kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe të biznesit;

- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë. Konkretisht, nga dhënia e kësaj mase shihet qartë se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me ç'rast konkurrenca dëmtohet ose mund të dëmtohet përmes mundësimit të një përparësie ekonomike për ndërmarrjen konkrete, Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.

Përveç konstatimit se masa e lartpërmendur paraqet ndihmë shtetërore, KMK-ja konstatoi gjithashtu se kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale**, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të ndërlidhura me investimet**.

KMK-ja gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur **paraqet ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që nuk është ndihmë shtetërore që jepet në bazë të një skeme ndihme, por jepet me detyrimin për miratim plotësues nga ana e KMK-së.

Gjatë vlerësimit të lejueshmërisë së dhënies së ndihmës, KMK-ja përcakton nëse dhënia e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës rajonale.

Dhënësi i ndihmës shtetërore do t'ia paguajë këtë ndihmë shtetërore përfituesit të ndihmës shtetërore brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për pagesë nga dhënësi i ndihmës shtetërore, vetëm me kusht që përfituesi i ndihmës shtetërore t'i ketë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të përcaktuara në Propozim-marrëveshje.

- Masa**: Pagesa e 50% të tatimit të paguar mbi të ardhurat personale në bazë të pagës për të punësuarit e angazhuar për herë të parë nga përfituesi i ndihmës shtetërore në periudhën ndërmjet datës së fillimit (01.04.2026) dhe datës së përfundimit (datës në të cilën përfituesi i ndihmës shtetërore do ta njoftojë dhënësin e ndihmës shtetërore se e ka realizuar projektin investues, datë e cila nuk mund të jetë më e vonshme se 31.12.2029), të angazhuar ekskluzivisht për nevojat e Projektit Investues të përshkruar në Planin e Biznesit, për të cilët paguhet pagë mesatare mujore neto më e lartë për së paku 50% nga lartësia e pagës minimale neto të përcaktuar me Ligjin për Pagën Minimale, e cila ka qenë në fuqi gjatë asaj periudhe, për më së shumti 2000 (dy mijë) të punësuar, e llogaritur dhe e paguar nga përfituesi i ndihmës shtetërore në përputhje me Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, ndërmjet Datës së Fillimit dhe Datës së Përfundimit,**

e paraparë në nenin 4 të Propozim-marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, **paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, për shkak se i plotëson kushtet e mëposhtme kumulative:

- Një masë e tillë përfshin transferimin e mjeteve shtetërore, për shkak se mjetet ndahen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.
- Selektiviteti i masës shihet në faktin se ndihma është e destinuar vetëm për një ndërmarrje konkrete – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, për shkak të së cilës vjen deri te prishja e ekuilibrit ndërmjet ndërmarrjes dhe konkurrentëve të saj. Konkretisht, selektiviteti i masës shihet edhe në faktin se, me dhënien e ndihmës shtetërore për një ndërmarrje, në rastin konkret – Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir, ndërmarrjet e tjera që ekzistojnë dhe veprojnë në të njëjtin treg për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike vendosen në pozitë të pafavorshme. Në këtë mënyrë, me dhënien e ndihmës shtetërore për këtë masë, Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir gjendet në pozitë selektive, duke pasur parasysh faktin se këto mjete mund t'i shfrytëzojë në mënyrën më fitimprurëse për të, me qëllim të arritjes së fitimit më të madh;
- Përparësia ekonomike për përfituesin shihet në favorizimin e një ndërmarrjeje konkrete – Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir dhe prodhimit të saj të pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, përparësi të cilën kjo ndërmarrje nuk do ta kishte në kushte normale të tregut dhe të biznesit;
- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë. Konkretisht, nga dhënia e kësaj mase shihet qartë se përfituesi është i përfshirë në veprimtari ekonomike dhe se do të operojë në tregun ku veprojnë edhe konkurrentë të tjerë, me ç'rast konkurrenca dëmtohet ose mund të dëmtohet përmes mundësimit të një përparësie ekonomike për ndërmarrjen konkrete, Shoqërinë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir.

Përveç konstatimit se masa e lartpërmendur paraqet ndihmë shtetërore, KMK-ja konstatoi gjithashtu se kjo masë, e destinuar për realizimin e projektit investues për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete motorike, paraqet **ndihmë rajonale**, në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 11 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që është në përputhje me qëllimet e politikës rajonale të Republikës së Maqedonisë së Veriut **për mbështetjen e investimeve fillestare produktive ose hapjen e vendeve të punës të ndërlidhura me investimet**.

KMK-ja gjithashtu konstatoi se masa e lartpërmendur **paraqet ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi që nuk është ndihmë shtetërore që jepet në bazë të një skeme ndihme, por jepet me detyrimin për miratim plotësues nga ana e KMK-së.

Dhënësi i ndihmës shtetërore do t'ia paguajë këtë ndihmë shtetërore përfituesit të ndihmës shtetërore brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për pagesë nga dhënësi i ndihmës shtetërore, vetëm me kusht që përfituesi i ndihmës shtetërore t'i ketë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të përcaktuara në Propozim-marrëveshje.

Gjatë vlerësimit të lejueshmërisë së dhënies së ndihmës, KMK-ja përcakton nëse dhënia e ndihmës bëhet në përputhje me Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe procedurës për dhënien e ndihmës rajonale.

Përfituesi i ndihmës shtetërore duhet të investojë shpenzime të arsyeshme investuese në shumën prej së paku 6.000.000 (gjashtë milionë) euro në kundërvlerë në denarë për projektin investues deri në datën e përfundimit. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e përmbush kushtin për të investuar shpenzime të arsyeshme investuese në shumën prej së paku 6.000.000 euro në kundërvlerë në denarë për projektin investues deri në datën e përfundimit, ai nuk do të ketë të drejtë në ndihmë shtetërore në përputhje me Marrëveshjen për Ndihmë Shtetërore.

Shuma e shpenzimeve të arsyeshme investuese do të llogaritet në bazë të dokumenteve zyrtare në formë të shkruar (kontrata për furnizim, kontrata për shitblerje/ndërtim, fatura, dokumente doganore, ekstrakte bankare etj.), me të cilat vërtetohen shpenzimet investuese të kryera nga përfituesi i ndihmës shtetërore.

Në përputhje me Planin e Biznesit, Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime KROMBERG & SCHUBERT MAQEDONI BT SHPKNJP Manastir planifikon të punësojë më së shumti 2000 (dy mijë) persona në periudhën ndërmjet datës së fillimit dhe datës së përfundimit.

Përfituesi i ndihmës obligohet ta mirëmbajë investimin, përkatësisht asetet (objektet, makineritë, pajisjet), në gjendje prodhuese, operative dhe të përdorshme (domethënë, nuk do ta zvogëlojë vlerën e aseteve), për një periudhë prej së paku 5 vjetësh nga data e përfundimit të projektit investues. Nëse përfituesi i ndihmës shtetërore nuk e mirëmban investimin, duhet ta kthejë të gjithë shumën e ndihmës shtetërore të përfituar në përputhje me Marrëveshjen për Ndihmë Shtetërore, së bashku me normën e interesit ndëshkues, të llogaritur në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën duke filluar nga pagesa e parë e kryer nga dhënësi i ndihmës shtetërore te përfituesi i ndihmës shtetërore, deri në momentin kur përfituesi i ndihmës shtetërore do ta kthejë shumën e përgjithshme të përfituar në llogarinë e dhënësit të ndihmës shtetërore.

Përfituesi i ndihmës do të financojë së paku 25% të shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues nga burimet e veta ose me financim nga një palë e tretë, në formë e cila nuk paraqet ndihmë shtetërore sipas Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Ndihma shtetërore rajonale kumulative për projektin investues nuk mund të jetë më e madhe se 50% e shumës së konfirmuar të të gjitha shpenzimeve të arsyeshme investuese të realizuara deri në datën e përfundimit, duke përfshirë edhe shpenzimet e arsyeshme investuese të realizuara deri në datën e përfundimit, të cilat tejkalojnë shumën minimale të kontraktuar të investimit prej 6.000.000 milionë eurosh si shpenzime të arsyeshme investuese.

Çdo ndihmë individuale e paraparë me Propozim-marrëveshjen do të jepet vetëm nëse përfituesi dorëzon dokumentacionin e plotë në përputhje me Marrëveshjen, me të cilin dëshmohet se janë përmbushur kushtet e kontraktuara.

Për arsyet e lartpërmendura, KMK-ja vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore. Padia nuk e shtyn ekzekutimin e

aktvendimit, përveç në rastin kur KMK-ja urdhëron kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, dhënia e së cilës nuk lejohet.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ